



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë



National Endowment for Democracy
Supporting freedom around the world

BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË

EDICION SPECIAL: PERCEPTIMET E QYTETARËVE DHE
PËRGJIGJA E KOMUNITETIT NDAJ LUFTËTARËVE TË HUAJ
TË KTHYER NË KOSOVË

Autore: Vesë Kelmendi

Redaktimi i brendshëm: Florian Qehaja, Mentor Vrajolli, Skender Perteshi

Redaktimi i jashtëm: Garentina Kraja

Lektura: Rudine Jakupi

Metodologjia e të dhënave: Mentor Vrajolli

Ky raport në formën e tij origjinale është shkruar në gjuhën angleze.

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta mbrojnë të drejtat dhe pronën intelektuale.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen me shkrim të botuesit. Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i asnjë materiali të botuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim nga QKSS. Ju lutemi të kontaktoni: info@qkss.org ose +381 38 221 420.

Perceptimet e paraqitura në këtë raport janë përmbledhje e përgjigjeve të marra nga të anketuarit dhe demonstrojnë vetëm mënyrën si i perceptojnë ata institucionet. Ai assesi nuk paraqet vlerësim përfundimtar të cilësisë së punës së institucioneve që i janë nënshtruar këtij studimi. Raporti do t'i shërbejë atyre si instrument për të adresuar mangësitë e mundshme, por edhe si tregues i efektivitetit të komunikimit të tyre me qytetarët. Pikëpamjet e paraqitura në këtë raport janë perceptimet e të anketuarve dhe nuk përfaqësojnë medoemos pikëpamjet e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë.

Opinionet e shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë medoemos pikëpamjet e fondacionit National Endowment for Democracy (NED).



QKSS
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë



National Endowment for Democracy
Supporting freedom around the world

BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË

EDICION SPECIAL: PERCEPTIMET E QYTETARËVE DHE
PËRGGJIGJA E KOMUNITETIT NDAJ LUFTËTARËVE TË HUAJ
TË KTHYER NË KOSOVË

PËRMBAJTJA

SHKURTESAT KRYESORE	5
ÇKA ËSHTË BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË?	6
GJETJET KRYESORE:.....	7
HYRJE.....	8
1. PERCEPTIMET E QYTETARËVE RRETH EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM I MOTIVUAR NË BAZË ETNIKE, POLITIKE DHE FETARE	10
2. PERCEPTIMET E PËRGJITHSHME PËR RREZIKUN QË PARAQITET NGA LUFTËTARËT E HUAJ TË KTHYER NË KOSOVË	13
3. PËRGJIGJET E KOMUNITETIT NDAJ ISH-LUFTËTARËVE TË KTHYER.....	16
3.1 Masat “e ashpëra” apo “të buta”?	19
4. BESUESHMËRIA E QYTETARËVE NDAJ INSTITUCIONEVE KRYESORE TË PËRFSHIRA NË ZBATIMIN E STRATEGJISË SË KOSOVËS PËR EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM ...	22

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Perceptimi i përgjithshëm për ekstremizmin e dhunshëm 2017.....	10
Figura 2: Perceptimet e qytetarëve për format e ndryshme të ekstremizmit të dhunshëm në bazë: etnike, politike dhe fetare	11
Figura 3: Perceptimet e qytetarëve për ndjenjat e tyre ndaj kombit dhe fesë.....	12
Figura 4: Perceptimet e përgjithshme në lidhje me luftëtarët e huaj të kthyer si rrezik për sigurinë	13
Figura 5: Perceptimi gjinor ndaj luftëtarëve të kthyer si rrezik për sigurinë	14
Figura 6: Perceptimi i qytetarëve në zonat rurale/urbane lidhur me luftëtarët e kthyer si rrezik për sigurinë	15
Figura 7: Perceptimet e përgjithshme: Përgjigjet e komunitetit për pranimin e ish-luftëtarëve të kthyer në komunitetin e tyre	17
Figura 8: Perceptimet e ndara sipas rajoneve rreth pranimin të luftëtarëve të huaj të kthyer në komunitetin e tyre.....	18
Figura 9: Përgjigjet sipas gjinisë për pranimin e luftëtarëve të kthyer në komunitetin e tyre.....	19

Figura 10: Perceptime të përgjithshme në lidhje me trajtimin e luftëtarëve të huaj të kthyer	20
Figura 11: Perceptimi i zonave rurale/urbane për trajtimin e ish-luftëtarëve të kthyer në Kosovë.....	21
Figura 12: Besimi i publikut ndaj institucioneve kryesore të përfshira në zbatimin e Strategjisë së Kosovës për ekstremizmin e dhunshëm	22
Figura 13: Trendet sipas viteve: besimi ndaj Bashkësisë Islame të Kosovës	23

SHKURTESAT KRYESORE

BIK	Bashkësia Islame e Kosovë
BKS	Barometri Kosovar i Sigurisë
EDH	Ekstremizmi i dhunshëm
IL	Ish-luftëtarët
KEDH	Kundërvënia ndaj ekstremizmit të dhunshëm
QK	Qeveria e Kosovës
QKSS	Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

ÇKA ËSHTË BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË?

Barometri Kosovar i Sigurisë (BKS) është program i veçantë i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS).

Qëllimi parësor i tij është që ta masë besimin e publikut ndaj institucioneve të sigurisë dhe të drejtësisë në Kosovë, si dhe të masë perceptimin e qytetarëve lidhur me kërcënimet e brendshme dhe të jashtme ndaj sigurisë në Kosovë.

BKS është sipërmarrja e parë dhe njëkohësisht më e madhe e këtij lloji e dizajnuar, zbatuar dhe komunikuar nga një institut vendor think-tank në Kosovë.

Veçori unike e BKS-së në Kosovë është neutraliteti politik. Si një think-tank i pavarur, QKSS nuk ka kufizime politike në komunikimin e gjetjeve dhe mesazheve të anketës.

BKS kryhet duke kombinuar metodat sasiore dhe cilësore që ofrojnë rezultate objektive dhe të besueshme. Të dhënat e barometrit grumbullohen përmes intervistave ballë për ballë me të anketuar të përzgjedhur rastësisht nga hulumtuesit e QKSS-së në terren në tërë territorin e Kosovës.

Pyetësi i BKS-së kryesisht përbëhet nga pyetje të mbyllura në formë të shkallës Likert me pesë pikë, të pasuara nga disa pyetje të hapura që i lejojnë të anketuarve të japin mendimet e tyre pa opsione të paracaktuara.

Ekipet e QKSS-së të përbëra nga 22 hulumtues në terren kanë kryer mostrimin, pilotimin dhe intervistat. Mostra kombëtare nga e cila u nxjerrën rezultatet e hulumtimit përfshiu 1,125 familje, duke ndjekur një mostër përfaqësuese të popullsisë mbi 18 vjeç në Kosovë.

Zbërthimi etnik i të anketuarve të intervistuar ishte: 90 për qind shqiptarë, 7 për qind serbë dhe

3 për qind të tjerë (turq, boshnjakë, romë, ashkali, egjiptianë, goranë, kroatë dhe malazezë) që pasqyrojnë përbërjen etnike të Kosovës.

Korniza e mostrës u bazua në zonat e kodit telefonik dhe, si e tillë, përfshiu 8 rajonet e mëposhtme: Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë Jug, Mitrovicë Veri, Pejë, Prishtinë dhe Prizren.

Faza e parë e grumbullimit gjeografik u bazua në Raportin e regjistrimit të popullsisë së Kosovës nga viti 2012. Faza e dytë përfshiu grumbullimin e mostrave sipas zonës komunale me mostër të shtresëzuar rurale/urbane sipas numrit të familjeve. Në fazën e fundit u ndoq metoda e mostrimit të rastësishëm duke përdorur 'metodën e ditëlindjes' më të afërt.

Mostrimi i rastësishëm siguron që çdo banor në Kosovë ka gjasë të barabartë për t'u përzgjedhur për intervistë. Me mostrën e përdorur për këtë studim, rezultatet e anketës pasqyrojnë trendet e qëndrimeve dhe perceptimeve në mesin e të gjithë popullsisë së moshës madhore në Kosovë në përgjithësi. Margjina e gabimit është 3 për qind me një interval konfidence prej 95 për qind.

Një intervistë pilote u krye në mes të shtatorit 2017 për të testuar realizueshmërinë e pyetësorit para fillimit të punës në terren. Ekipi hulumtues më pas raportoi se intervista pilote ishte e suksesshme, dhe nuk kishte probleme me instrumentin pilot. Të gjitha intervistat u kryen nga 5 deri më 11 tetor 2017. Përpunimi dhe analiza e të dhënave u bë duke përdorur softuerin SPSS. Perceptimet e paraqitura në këtë raport janë përmbledhje e përgjigjeve të marra nga të anketuarit dhe demonstrojnë mënyrën si qytetarët i perceptojnë institucionet dhe sfidat tjera në Kosovë.

GJETJET KRYESORE:

- Ky raport gjen se 75 për qind e të anketuarve besojnë se ekstremizmi i dhunshëm paraqet kërcënim për sigurinë kombëtare të Kosovës.
- Besimi në institucionet kryesore (qeveria, kuvendi, gjykatat, prokuroria dhe Policia e Kosovës) që janë të përfshira në zbatimin e Strategjisë kombëtare kundër ekstremizmit të dhunshëm është shumë i ulët krahasuar me Policinë e Kosovës, e cila shquhet si një nga institucionet më të besueshme. Besimi për BIK-un vazhdon të bie në krahasim me dy vitet e fundit.
- Rreth gjysma e të anketuarve e shohin ekstremizmin politik si kërcënim në krahasim me 30 për qind që shohin dhunën etnike si një kërcënim për sigurinë kombëtare. Njëzet e pesë për qind e të anketuarve konsiderojnë se ekstremizmi i dhunshëm me bazë fetare paraqet kërcënim.
- Vetëm 34 për qind e të anketuarve janë të përkushtuar ndaj çështjes kombëtare, ndërsa 15 për qind e të anketuarve janë të përkushtuar ndaj çështjes fetare. Të dhënat tregojnë se të anketuarit më të rinj kultivojnë ndjenjat fetare më shumë sesa brezi i vjetër. Kjo gjetje është në përputhje me raportin e mëparshëm të QKSS-së të vitit 2015. Pesëdhjetë e dy për qind e të anketuarve më të rinj (nga 18-35 vjeç) preferojnë të angazhohen për një çështje fetare sesa për një çështje kombëtare, krahasuar me 72 për qind të të anketuarve më të vjetër (mbi 35 vjeç) që do të angazhoheshin për një çështje kombëtare.
- Raporti i BKS-së konstaton se të anketuarit në zonat rurale mendojnë se ish-luftëtarët e kthyer paraqesin rrezik më të lartë në krahasim me të anketuarit në zonat urbane.
- Rezultatet e BSK 2017 tregojnë se gratë i shohin luftëtarët e kthyer rrezik më të lartë në krahasim me burrat. Kjo gjetje konfirmohet nga perceptimet mbi trajtimin e luftëtarëve të huaj të kthyer dhe pranimin e tyre në komunitet, me 69 për qind të grave të anketuara që pohojnë se nuk do të praninin luftëtarët e kthyer në komunitetin e tyre, krahasuar me 53 për qind të të anketuarve burra që pohuan të njëjtën gjë.
- Të dhënat tregojnë se 62 për qind, ose shumica e të anketuarve, thonë se nuk do të praninin ish-luftëtarët të kthyer në lagjen ose komunitetin e tyre, ndërsa vetëm 25 për qind e të anketuarve deklaruan se do të praninin të kthyerit me mbikëqyrje të vazhdueshme nga shteti.
- Shumica e të anketuarve ose 49 për qind konsiderojnë se luftëtarët e huaj të kthyer duhet të ri-integrohen përmes programeve rehabilituese (me mbikëqyrjen e organeve të zbatimit të ligjit). Njëzet e shtatë për qind e të anketuarve besojnë se ish-luftëtarët e kthyer duhet të arrestohen, ndërsa vetëm 15 për qind e të anketuarve mendojnë që të kthyerit nuk duhet t'u lejohet të kthehen në Kosovë.

- Të dhënat tregojnë se rajonet si Prishtina, Mitrovica, Peja, Gjakova, Ferizaj dhe Mitrovica e Veriut hezitojnë të pranojnë luftëtarët e kthyer në komunitetin e tyre. Të anketuarit nga Gjilani dhe Prizreni janë disi më të hapur për t'i pranuar këta individë në komunitetin e tyre.

HYRJE

Gjatë tre viteve të fundit ekstremizmi i dhunshëm ka dominuar diskursin publik, me fokus të veçantë në kërcënimet dhe trajtimin e ish-luftëtarëve të huaj të kthyer nga zonat e kontrolluara më parë nga ISIS. Ri-integrimi i luftëtarëve të kthyer dhe familjeve të tyre përbën sfidën kryesore për institucionet e Kosovës dhe për të gjitha shtetet të tjera të cilat janë ballafaquar me këtë dukuri. Sipas të dhënave të institucioneve të sigurisë deri më tani, rreth 120 shtetas të Kosovës të cilët kanë marrë pjesë në luftën në Siri dhe Irak ose kanë jetuar në zonat e prekura, përfshirë 7 gra, janë kthyer në Kosovë. Shumica e atyre që janë kthyer në Kosovë kanë kaluar nëpër sistemin e drejtësisë, disa prej tyre janë ndaluar, dhe të tjerët janë ende në procedurat gjyqësore. Sidoqoftë, shumica e luftëtarëve të kthyer pritet të përfundojnë vuajtjen e dënimit me burg, të tjerët jetojnë në izolim dhe mbikëqyrje, dhe disa që priten të kthehen në muajt në vijim nga konflikti i Sirisë dhe Irakut. Shoqëria dhe institucionet e Kosovës po çalojnë në arritjen e baraspeshës midis përgjegjësisë për të adresuar këtë sfidë dhe masave ndëshkuese që do ta ndihmonin Kosovën në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm.

Strategjia kombëtare për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që shpie në terrorizëm 2015-2020, përcakton se fokusi kryesor mbetet tek personat e identifikuar apo grupet potencialisht të prekshme nga ideologjitë e ekstremizmit të dhunshëm, me qëllim të ri-integrimit të tyre në shoqëri. Sipas Strategjisë, ri-integrimi i personave potencialisht të radikalizuar ose në fazën e radikalizimit duhet të jetë një proces gjithëpërfshirës dhe specifik. Më tej, Parimet e Maltës për ri-integrimin e luftëtarëve të huaj terroristë të kthyer theksojnë se duhet të bëhen vlerësime efektive për të dizajnuar programe enkas për individët, varësisht nëse janë për luftëtarët e kthyer, familjet e tyre ose individët e prekshëm.¹ Duke pasur parasysh rëndësinë e ri-integrimit dhe rolin vendimtar të komunitetit në procesin e rehabilitimit të luftëtarëve të huaj, qëllimi kryesor i këtij raporti është që të hedhë dritë mbi mënyrën se si procesi i ri-integrimit perceptohet nga popullata e përgjithshme e Kosovës,

1 National Strategy on Prevention Violent Extremism and radicalization leading to http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGY_parandalim_-_ENG.pdf

cilat janë mendimet dhe bindjet kryesore të qytetarëve të Kosovës lidhur me ekstremizmin e dhunshëm dhe si duhet të trajtohen ish-luftëtarët e huaj nga shoqëria në përgjithësi.

Barometri Kosovari i Sigurisë (BKS) mbi përgjigjen e komunitetit ndaj të kthyerve mbështetet kryesisht në pikëpamjet e mbledhura përmes pyetjeve të mbyllura që matin opinionin e qytetarëve për këtë çështje. Përveç kësaj, përmes pyetjes së hapur, të anketuarve iu kërkua të përshkruajnë shkurtimisht rreziqet dhe kërcënimet kryesore me të cilat ballafaqohen qytetarët e Kosovës. Kërcënimet e theksuara më së shpeshti nga të anketuarit në pyetjet e hapura ishin ato që lidhen me situatën aktuale kritike socio-ekonomike, polarizimin politik, tensionet midis Kosovës dhe Serbisë, krimin e rëndomtë, ekstremizmin e dhunshëm dhe rreziqet mjedisore.² Ky raport konstaton se shumica e të anketuarve konsiderojnë se luftëtarët e kthyer nga konflikti i Sirisë dhe Irakut paraqesin rrezik për sigurinë kombëtare, dhe kjo konfirmohet edhe në qëndrimet dhe gatishmërinë e tyre për të pranuar luftëtarët e huaj të kthyer në komunitetet e tyre. Shumica e të anketuarve deklaruan se nuk do t'i pranonin ata në komunitetin e tyre. Nga ana tjetër, perceptimet e qytetarëve e konsiderojnë pozitivisht ofrimin e trajtimit për luftëtarët e kthyer, shumica e të anketuarve u shprehën në mbështetje të programeve të ri-integrimit për personat e kthyer nga zonat e konfliktit. Kjo gjetje qëndron për tërë Kosovën, me përjashtim të Gjakovës ku një pjesë më e madhe e të anketuarve thonë se të kthyerit duhet të burgosen.

Ky raport ndahet në tri pjesë. Pjesa e parë e raportit përbëhet nga një përshkrim i përgjithshëm i perceptimit të publikut mbi ekstremizmin e dhunshëm bazuar të dhënat e grumbulluara në vitin 2017. Këto kategorizohen në kërcënime të motivuara në bazë etnike, ekstremizëm të dhunshëm me bazë fetare dhe ekstremizëm të dhunshëm të motivuar politikisht. Përveç kësaj, raporti analizon qëndrimin e të anketuarve ndaj çështjeve kombëtare dhe fetare.

Pjesa e dytë dhe kryesore e raportit paraqet perceptimet e të anketuarve për ish-luftëtarët e kthyer. Ajo vlerëson kërcënimin dhe rrezikun, si dhe gatishmërinë e komunitetit për t'i pranuar ata aty ku jetojnë dhe perceptimet e përgjithshme në lidhje me trajtimin e ish-luftëtarëve të kthyer.

Gjetjet e këtij raporti kategorizohen në bazë të karakteristikave të mëposhtme të të anketuarve: zona e banimit (rurale/urbane), komuniteti ku jetojnë, gjinia dhe mosha. Në fund, pjesa e tretë e raportit analizon besimin ndaj qeverisë, kuvendit, gjykatave, prokurorisë dhe Policisë së Kosovës, të gjithë hisedarëve kryesorë në zbatimin e Strategjisë së Kosovës për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Raporti përmbledh gjithashtu trendet përgjatë viteve sa i përket besimit ndaj Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK).

2 Vrajolli, M "Kosovo security Barometer- Seventh Edition" 2017 http://www.qkss.org/repository/docs/KOSOVO_SECURITY_BAROMETER_7_ENGLISH_FINAL_891249.pdf

1. PERCEPTIMET E QYTETARËVE RRETH EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM I MOTIVUAR NË BAZË ETNIKE, POLITIKE DHE FETARE

Meqenëse ky raport synon të jap hollësi rreth perceptimeve të qytetarëve për ekstremizmin e dhunshëm, është e nevojshme të kuptohet se cka konsiderohet ekstremizëm i dhunshëm nga publiku i gjerë në Kosovë. Sipas perceptimeve të përgjithshme publike, ekstremizmi i dhunshëm nuk kufizohet vetëm në dukurinë e ish-luftëtarëve të kthyer nga konflikti i Sirisë dhe Irakut, por përfshin edhe incidentet e motivuara politikisht dhe etnikisht.

Nga pyetjet e mbyllura në kuadër të BKS 2017, të anketuarve iu kërkua që të përgjigjen se çka ata mendojnë se janë kërcënimet kryesore për sigurinë kombëtare të Kosovës. Në figurën e mëposhtme, shumica e të anketuarve, ose 74 për qind e atyre që janë anketuar, e shohin dukurinë e ekstremizmit të dhunshëm si një rrezik real për sigurinë kombëtare të Kosovës. Të dhënat e këtij raporti sygjerojnë që ekstremizmi i dhunshëm në Kosovë është shfaqur edhe në forma të tjera, përveç i motivuar në baza fetare, siç janë ekstremizmi i dhunshëm i motivuar etnikisht dhe politikisht.




Figura 1: Perceptimi i përgjithshëm për ekstremizmin e dhunshëm 2017

Rreth 50 për qind e të anketuarve vlerësuan se ekstremizmi politik është kërcënim, ndërsa 30 për qind e të anketuarve deklaruan se dhuna në baza etnike paraqet kërcënim për sigurinë

kombëtare të Kosovës. Përgjithësisht, të anketuarit e shohin dhunën fetare si rrezik më të vogël krahasuar me ekstremizmin të motivuar në baza politike dhe etnike. Për shembull, rreth 25 për qind e të anketuarve e shohin dhunën në bazë fetare si rrezik, ndërsa 28 për qind e konsideruan këtë dukuri si rrezik mesatar i sigurisë në vend. Pjesa e mbetur apo 44 për qind e të anketuarve nuk e shohin aspak rrezik ekstremizmin të motivuar në baza fetare.

Sipas Raportit të vlerësimit të rrezikut të publikuar nga QKSS, rreth 73 incidentet e regjistruara të kërcënimeve në databazën e QKSS-së, shumica ose afër 62 për qind ishin incidente politike, ndërsa rreth 36 për qind ishin incidente të natyrës fetare.³ Vlerësimi gjithashtu tregon se normat e ekzekutimit në mesin e të gjitha kërcënimeve të regjistruara (kërcënimet që shkuan përtej paralajmërimeve verbale ose që nuk ishin parandaluar nga nga autoritetet), ishin shumë më të larta në llojin politik të kërcënimeve, sesa në llojin e kërcënimeve fetare.⁴ Nga ky numër i përgjithshëm i kërcënimevetë regjistruara, 4 incidente të motivuara në bazë fetare që rezultuan me vdekje, asnjë prej tyre nuk ishte kërcënim i brendshëm për shkak ndodhën jashtë territorit të Kosovës. Nga pikëpamja statistikore, numri i viktimave, për nga aspekti i vdekjeve apo lëndimeve, mbetet i parëndësishëm. Kur shqyrtohet numri mesatar i viktimave kundrejt numrit të përgjithshëm të kërcënimeve, bëhet e evidente se ka pasur 1 vdekje dhe 1 lëndim në një periudhë shtatëvjeçare.⁵

Ekstremizmi i dhunshëm i motivuar:




Figura 2: Perceptimet e qytetarëve për format e ndryshme të ekstremizmit të dhunshëm në bazë: etnike, politike dhe fetare

- 3 Kursani.Sh "Kosovo Risk assessment report since independence - February 2008 - June 2017" Kosovar Center for Security Studies, 2017 http://www.qkss.org/repository/docs/KS-RiskAssessment-eng_201377.pdf
- 4 Kursani.Sh "Kosovo Risk assessment report since independence - February 2008 - June 2017" Kosovar Center for Security Studies, 2017 http://www.qkss.org/repository/docs/KS-RiskAssessment-eng_201377.pdf
- 5 Kursani.Sh "Kosovo Risk assessment report since independence - February 2008 - June 2017" Kosovar Center for Security Studies, 2017 http://www.qkss.org/repository/docs/KS-RiskAssessment-eng_201377.pdf

Në BSK 2017, të anketuarit u pyetën për ndjenjat e tyre ndaj kombit dhe fesë. Për shembull, 49 për qind e të anketuarve shprehen ndjenja të barabarta ndaj çështjes kombëtare dhe fetare. Vetëm 34 për qind të të anketuarve u shprehen të përkushtuar ndaj çështjes kombëtare, ndërsa 15 për qind e të anketuarve u shprehen të përkushtuar ndaj çështjes fetare. Megjithatë, kjo ndryshon paksa kur kategorizojmë përgjigjet e të anketuarve sipas moshës. Të anketuarit e rinj kanë më shumë ndjenja fetare krahasuar me të anketuarit e moshuar dhe gjetje të ngjashme janë paraqitur edhe në raportet të tjera të publikuara nga QKSS në vitin 2015. Ky raport i gjen se 52 për qind e të anketuarve më të rinj (nga 18-35 vjeç) preferojnë të angazhohen për çështje fetare sesa për çështje kombëtare, krahasuar me 72 për qind të të anketuarve më të moshuar (mbi 35 vjeç) që do të angazhoheshin për një çështje kombëtare. Mund të ketë shumë faktorë shpjegues përse të anketuarit e rinj mund të ndjehen më të lidhur me kauzën fetare, sepse nuk ka ndonjë kauzë madhore kombëtare e cila mund t'i bashkojë në krahasim me të anketuarit më të moshuar, që kanë përjetuar një periudhë të historisë së Kosovës që i mobilizoi ata për t'u angazhuar në kërkesën për liri dhe shtet-ndërtim.

Një faktor tjetër që mund të shkaktojë që të rinjtë të jenë të lidhur më shumë me kauzën fetare, mund të jetë përjashtimi i tyre shoqëror, mungesa e lidhjes me shtetin dhe mungesa e mundësive për të zhvilluar apo punuar në vendin e tyre. Kjo mund të shihet në analizimin e statistikave marramendëse të punësimit nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, që tregojnë se 66% e të rinjve janë të papunë.⁶




Figura 3: Perceptimet e qytetarëve për ndjenjat e tyre ndaj kombit dhe fesë

⁶ Agjencia e Statistikave të Kosovës 2016: <http://ask.rks-gov.net/media/2488/afp-tm2-2016.pdf>, pg.25

2. PERCEPTIMET E PËRGJITHSHME PËR RREZIKUN QË PARAQITET NGA LUFTËTARËT E HUAJ TË KTHYER NË KOSOVË

BKS ka matur edhe rrezikun që paraqitet nga luftëtarët e huaj të kthyer në Kosovë, duke iu referuar kryesisht atyre që u kthyen nga konflikti në Siri dhe Irak. Sipas të dhënave të mbledhura, perceptimet e përgjithshme të qytetarëve janë se këta individë paraqesin rrezik për sigurinë në Kosovë. Veçanërisht, 70 për qind e të anketuarve deklaruan se këta individë paraqesin rrezik për sigurinë kombëtare, 12 për qind kanë shtuar se ka më pak rrezik nga luftëtarët e huaj, ndërsa vetëm 13 për qind e të anketuarve përjashtojnë çfarëdo risku që paraqitet nga të kthyerit.




Figura 4: Perceptimet e përgjithshme në lidhje me luftëtarët e huaj të kthyer si rrezik për sigurinë

Tutje, perceptimi i rrezikut të sigurisë që paraqitet nga luftëtarët e huaj të kthyer është jashtëzakonisht ngjashëm edhe në kuadër të rajoneve, gjinisë si dhe zonave rurale/urbane. Bazuar në perspektivat e komunave të Kosovës, mbi 66 për qind i konsiderojnë luftëtarët e huaj si kërcënim të drejtpërdrejtë për sigurinë e tyre, me përjashtim të të anketuarve nga Gjilani, ku vetëm 54 për qind besojnë se luftëtarët e huaj paraqesin rrezik. Për shembull, rreth 84 për qind e të anketuarve nga Gjakova deklaruan se këta individë paraqesin rrezik si dhe rreth 75 për qind e të anketuarve nga Prishtina besojnë se të kthyerit janë kërcënim për sigurinë kombëtare.

Perceptimet e publikut në baza gjinore tregojnë disa ndryshime ku shumica e grave të anketuara, shprehën shqetësim për rrezikun që mund të paraqitet nga luftëtarët e huaj, në krahasim me 61 për qind të burrave që ndajnë këto vlerësime. Njëzet për qind e të anketuarve burra deklaruan se luftëtarët e huaj të kthyer nuk paraqesin ndonjë rrezik për Kosovën në krahasim me vetëm 7 për qind të grave të anketuara që kishin të njëjtat pikëpamje. Gratë konsiderojnë se luftëtarët e huaj të kthyer kanë tendencë që të rekrutojnë të rinj të tjerë, dhe disa besojnë se luftëtarët e huaj ishin pjesë e konfliktit dhe si të tillë duhet të trajtohen para se t'i kthehen jetës së tyre në komunitet. Perceptimet e grave ndaj ekstremizmit të dhunshëm formohen kryesisht nga mediat, sepse krahasuar me burrat ato nuk kanë qasje të njëjtë në organizimet që bëhen në kuadër të komunës.




Figura 5: Perceptimi gjinor ndaj luftëtarëve të kthyer si rrezik për sigurinë

Një tjetër vështrim interesant i ofruar nga ky botim i BKS-së mbi rrezikun që paraqitet nga luftëtarët e huaj të kthyer, bazohet në qëndrimet rurale dhe urbane. Rezultatet në këtë rast tregojnë se deri në 73 për qind e të anketuarve nga zonat rurale i konsiderojnë luftëtarët e huaj të kthyer si një rrezik real për sigurinë, krahasuar me 68 për qind të të anketuarve që banojnë në zona urbane. Katërmëdhjetë për qind e të anketuarve nga zonat urbane deklaruan se luftëtarët e kthyer nuk paraqesin ndonjë rrezik për sigurinë në Kosovë, krahasuar me 12 për qind të të anketuarve që banojnë në zonat rurale.




Figura 6: Perceptimi i qytetarëve në zonat rurale/urbane lidhur me luftëtarët e kthyer si rrezik për sigurinë

3. PËRGJIGJET E KOMUNITETIT NDAJ ISH-LUFTËTARËVE TË KTHYER

Përveç matjes së kërcënimit të paraqitur nga luftëtarët e huaj, QKSS ka matur perceptimet e komunitetit lidhur me atë se si autoritetet shtetërore duhet të trajtojnë luftëtarët e huaj të kthyer në Kosovë. Arsyeshmëria për të matur këtë tregues rrjedh nga pikëpamja jonë për rolin kyç që luajnë komunitetet në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, por edhe në proceset e ri-integrimit.

Rezultatet e BKS 2017 tregojnë se ka mungesë gatishmërie nga qytetarët e Kosovës për t'i pranuar këta individë të kthyer dhe për t'i ri-integruar ata në komunitetin e tyre. Gjegjësisht, 62 për qind e të anketuarve deklaruan se nuk do t'i pranonin luftëtarët e huaj në lagjen apo komunitetin e tyre. Megjithatë, rreth 25 për qind e të anketuarve deklaruan se do t'i pranonin ata në komunitetin e tyre me kusht që ata të vendoseshin nën mbikëqyrjen e organeve për zbatim të ligjit. Njëmbëdhjetë për qind e të anketuarve thanë se nuk kanë fare problem me praninë e tyre në komunitetet e tyre.

Ka arsye të ndryshme që mund të shpjegojnë qëndrimin negativ të qytetarëve ndaj fenomenit të luftëtarëve të kthyer nga zonat e konfliktit. Disa prej tyre janë të lidhura me mizoritë e kryera nga ISIS në Siri dhe Irak dhe raportimin negativ që Kosova ka marrë në mediat ndërkombëtare si një 'terren pjellor' për rekrutim për ISIS, duke ngritur frikën se kërcënimet e tilla do të njollosin imazhin e Kosovës jashtë vendit dhe do të ndërlikojnë më tej pozitën e saj komplekse në arenën ndërkombëtare.

Të dhënat e mbledhura tregojnë se një nga sfidat kryesore të procesit të ri-integrimit të luftëtarëve të huaj është ngritja e vetëdijes për rëndësinë dhe përgjegjësinë e shoqërisë dhe institucioneve të Kosovës për të ndihmuar në rehabilitimin e luftëtarëve të huaj. Shumica e komuniteteve në Kosovë kanë shprehur gatishmërinë për programet e reja të integrimit të luftëtarëve të huaj, dhe për të mbështetur institucionet shtetërore në programet e rehabilitimit, por një pjesë e madhe e komuniteteve në zonat e kufirit me Maqedoninë janë stigmatizuar, si rezultat i raportimeve negative që janë bërë nga mediat ndërkombëtare.⁷ Një nga artikujt kryesorë ishte ai në maj të vitit 2016 në gazetën "New York Times" që paraqiti

⁷ Gazeta Tribuna "Ilazi-Kaçaniku nuk është vatër e xhihadistëve", 19 shkurt 2016 <http://gazetatribuna.com/lajme/ilazi-kacaniku-nuk-eshte-vater-e-xhihadisteve/>

mënyrën se si Kosova po shndërrohej “në terren pjellor për ISIS-in”⁸ Vëmendja e madhe e mediave ndërkombëtare ndaj dukurisë së ekstremizmit të dhunshëm ka qenë sipërfaqësore në dhënien e një pamjeje të plotë të situatës në terren dhe ka arritur të polarizojë shoqërinë dhe të kontribuoj në stigmatizimin e disa komuniteteve.⁹ Mungesa e qasjes pro-aktive nga ana e shtetit drejt ri-integrimit të luftëtarëve të huaj mund të shihet gjithashtu si një faktor kontribues për perceptimet negative të qytetarëve ndaj të kthyerve.




Figura 7: Perceptimet e përgjithshme: Përgjigjet e komunitetit për pranimin e ish-luftëtarëve të kthyer në komunitetin e tyre

Në këtë pjesë janë analizuar perceptimet e të anketuarve bazuar në rajonet prej nga vijnë. Të dhënat tregojnë se komunat si Prishtina, Mitrovica, Peja, Gjakova, Ferizaj dhe Mitrovica Veriore hezitojnë për të pranuar luftëtarët e huaj të kthyer në komunitetin e tyre, ndërsa të anketuarit nga Gjlani dhe Prizreni janë disi më të hapur për t’i pranuar këta individë në komunitetin e tyre.

8 New York Times “Hoë Kosovo Ëas Turned Into Fertile Ground for ISIS” 21 May 2016 <https://www.nytimes.com/2016/05/22/world/europe/hoë-the-saudis-turned-kosovo-into-fertile-ground-for-isis.html>

9 Augustad Knudsen.R “Radicalization and foreign fighters in the Kosovo context: An analysis of international media coverage of the phenomena” Norwegian Institute of International Affairs (NUPI) 2017, pg. 9-11




Figura 8: Perceptimet e ndara sipas rajoneve rreth pranimit të luftëtarëve të huaj të kthyer në komunitetin e tyre

Ngjashëm, nga perspektiva gjinore, vetëm 7 për qind e grave të anketuara deklaruan se nuk do ta kishin problem pranimit të kthyerve në komunitetin e tyre në krahasim me 17 për qind të të anketuarve burra që deklaruan të njëjtën gjë. Gjetjet e tilla duhet të na shërbejnë që të përfshijmë rolin e gruas në programet e rehabilitimit dhe ri-integrimit të luftëtarëve të kthyer në Kosovë. Roli i grave në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm është esecial meqë ato mund të bëjnë ndryshime rrënjësore në komunitetin e tyre, duke qenë të përfshira në programet e parandalimit dhe të interventimit të ekstremizmit të dhunshëm. Disa nga praktikat që mund të shërbejnë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm është edhe përfshirja e rolit të nënës pasi që ato mund të jenë në vijën e parë si identifikuese të fëmijeve të tyre në procesin e radikalizmit.




Figura 9: Përgjigjet sipas gjinisë për pranimin e luftëtarëve të kthyer në komunitetin e tyre

Raporti tutje analizozi përgjigjen e komunitetit lidhur me trajtimin e luftëtarëve të huaj të kthyer edhe në bazë të moshës së të anketuarve. Rezultatet treguan se nuk ka dallime të mëdha në mendimet mes të të anketuarve të rinj dhe më të moshuar. Megjithatë, të rinjtë i pranojnë luftëtarët e huaj më lehtë, krahasuar me të anketuarit mbi moshën 35 vjeç që hezitonin që të pranojnë luftëtarët e huaj në komunitetin e tyre.

3.1 Masat “e ashpëra” apo “të buta”?

Përveç matjes së pikëpamjeve të qytetarëve lidhur me trajtimin e luftëtarëve të huaj nga ana e institucioneve shtetërore dhe shoqërisë në përgjithësi, raporti gjithashtu paraqet dhe perceptimet se cilat janë masat më të përshtatshme institucionale për t’u marrë me luftëtarët e huaj të kthyer.

Figura e mëposhtme tregon se shumica e të anketuarve, ose 49 për qind, konsiderojnë se luftëtarët e huaj të kthyer duhet të ri-integrohen përmes programeve të sponsorizuara nga shteti, 27 për qind e të anketuarve besojnë se ish-luftëtarët e kthyer duhet të arrestohen, ndërsa 15 për qind e të anketuarve mendojnë se të kthyerit nuk duhet të lejohen të hyjnë në Kosovë. Gjetje të ngjashme qëndrojnë në të gjithë rajonet. Për shembull, të gjitha rajonet

ose më shumë se 50 për qind e të anketuarve deklaruan se të kthyerit duhet t'u nënshtrohen programeve të trajtimit ose ri-integrimit, me përjashtim të Gjakovës, ku duket se mbizotëron besimi se të kthyerit duhet të burgosen.




Figura 10: Perceptime të përgjithshme në lidhje me trajtimin e luftëtarëve të huaj të kthyer

Perceptime të ngjashme kishin edhe të anketuarit sipas zonave rurale dhe urbane. Rreth 46 për qind e të anketuarve nga zonat rurale deklaruan se luftëtarët e huaj të kthyer në Kosovë duhet të kalojnë nëpër programe të ri-integrimit në krahasim me 53 për qind që banojnë në zonat urbane. Rreth 30 për qind e të anketuarve nga zonat rurale deklaruan se këta individë duhet të burgosen krahasuar me 24 për qind të atyre urbane.




Figura 11: Perceptimi i zonave rurale/urbane për trajtimin e ish-luftëtarëve të kthyer në Kosovë

4. BESUESHMËRIA E QYTETARËVE NDAJ INSTITUCIONEVE KRYESORE TË PËRFSHIRA NË ZBATIMIN E STRATEGJISË SË KOSOVËS PËR EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM

Anketa e BKS-së mati perceptimin e përgjithshëm të besimit të qytetarëve ndaj institucioneve kryesore të sigurisë dhe të drejtësisë që janë përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë kombëtare kundër ekstremizmit të dhunshëm. Raporti përfshin trendet vjetore të besimit të qytetarëve ndaj Bashkësisë Islame të Kosovës, që është autoritet kryesor i besimtarëve myslimanë në Kosovë. Vetëm 14 për qind e qytetarëve të anketuar kanë besim në Qeverinë e Kosovës, 12 për qind e të anketuarve i besojnë Kuvendit të Kosovës krahasuar me 66 për qind e të anketuarve që nuk kanë besim në Kuvendin e Kosovës.¹⁰

Qytetarët kanë pikëpamje të ngjashmeedhe ndaj sistemit të drejtësisë, vetëm 29 për qind të anketuarve besojnë në Prokurori ndërsa 25 për qind e qytetarëve besojnë në gjykata.

Nga ana tjetër, Policia e Kosovës është institucioni më i besuar, me 61 për qind e të anketuarve që deklaruan se kanë besim në Policinë e Kosovës. Për më shumë hollësi rreth kësaj shih edicionin e fundit të BKS.¹¹



Figura 12: Besimi i publikut ndaj institucioneve kryesore të përfshira në zbatimin e Strategjisë së Kosovës për ekstremizmin e dhunshëm

10 Vrajolli. M "Kosovo security Barometer- Seventh Edition" 2017 http://www.qkss.org/repository/docs/KOSOVO_SECURITY_BAROMETER_7_ENGLISH_FINAL_891249.pdf

11 Vrajolli. M "Kosovo security Barometer- Seventh Edition" 2017 http://www.qkss.org/repository/docs/KOSOVO_SECURITY_BAROMETER_7_ENGLISH_FINAL_891249.pdf

Ky raport gjithashtu analizo besimin e qytetarëve ndaj institucioneve të tjera që përfshihen në Strategjinë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, veçanërisht Bashkësisë Islame të Kosovës. Bashkësia Islame e Kosovës, si autoritet kryesor i ushtruesve të fesë myslimane, luan rol të rëndësishëm në programet e ri-integrimit të të kthyerve brenda dhe jashtë burgjeve të Kosovës. Prandaj, është e domosdoshme të analizohet se si e shohin këtë institucion qytetarët e Kosovës. Ky raport konstaton se besimi ndaj Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK) është më i lartë krahasuar me institucionet e vendit si Qeveria dhe institucionet e sigurisë dhe drejtësisë. Sidoqoftë, besimi ndaj BIK ka rezultuar që të zvogëlohet krahasuar me dy vitet e fundit.¹² Siç shihet në figurën e mëposhtme, në vitin 2015, qytetarët i besonin BIK-ut me 59 për qind, ndërsa në vitin 2016 perceptimet e qytetarëve rezultuan me 46 për qind. Në vitin 2017, vetëm 40 për qind e të anketuarve kanë besim në Bashkësinë Islame të Kosovës. Nga këto të dhëna shohim që është e rëndësishme që edhe BIK-u të punojë më shumë për ta kthyer besimin e qytetarëve.




Figura 13: Trendet sipas viteve: besimi ndaj Bashkësisë Islame të Kosovës

12 QKSS, Barometri Kosovari i Sigurisë, Perceptimet e qytetarëve për ekstremizmin e dhunshëm 2015-2016

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

351.746.1(496.51)(048)

327(497.11:496.51)(048)

Kelmendi, Vesë

Citizens perception and community response on returned foreign fighters /
Vesë Kelmendi. – Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2018. – 25
f. : ilustr. ; 21 cm.

ISBN 978-9951-679-77-0

ISBN 978-9951-679-77-0



9 789951 679770

www.qkss.org